

V E N D I M
Nr. 323, datë 4.7.2002

**PËR KALIMIN E KORPUSIT TREKATËSH TË "ALIMPEKS" SH.A.-SË SHKOZET,
DURRËS, NË PRONËSI TË MINISTRISË SË PUNËS DHE ÇËSHTJEVE SOCIALE**

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, 13 dhe 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit" dhe të nenit 2 të ligjit 7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Kalimin e magazinave të korpusit trekatësh, me pamje nga deti, me sipërfaqe ndërtimi 1182.9 m2 për çdo kat, që ndodhet në administrimin operativ të "Alimpeks", sh.a.-së, Shkozet, Durrës, në pronësi të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale për nevoja të invalidëve të punës, dega Tiranë.

2. Ngarkohet Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale për kalimin e objektit, të përmendur në pikën 1, në huapërdorim të Shoqatës së Invalidëve të Punës, dega Tiranë.

3. Ngarkohen Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe "Alimpeks", sh.a.-ja, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko